



REPUBLIKA E KOSOVË
Drejtoria e Inspeksionit
Glllogoc, me 05.05.2017



RAPORT PËR MUAJIN PRILL 2017

Gjatë këtij muaji sikur edhe në muajin e kaluar, me rëndësi të veçant janë inspektuar operatorët transportit rrugor, përkatsisht largimi i operatorëve ilegal, si dhe ndërtimet pa leje.

Për realizimin e këtyre punëve në mënyrë më efektive është inspektuar edhe gjatë ditëve të vikendit.

Në vazhdim po ju sjellë punët e kryera nga secili Inspektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Inspektori Sanitar ka inspektuar operatorët ushqimorë-marketet në kontrollë të produkteve të dyshimta sipas urdhëreses nga Inspektorati Qendror, shqyrtimin e kërkesave të palës si dhe kërkesat e subjekteve për pëlqim sanitar.

Inspektori i Ndërtimit përveq inspektimit të ndërtimeve pa leje, ka bërë inspektime sipas kërkeses gjatë fazave të ndërtimit me leje, gjithashtu ka qenë pjesë e komisionit për evidentim të subjekteve që kanë uzurpuar pronën publike.

Inspektori i Komunikacionit ka vazhduar me planin operativ në bashkpunim me PK-Njësi në Drenas rreth transportit të udhëtarëve, kontrollë e Operatorëve ilegal duke marrë masat e radhes-fletëparaqitje dhe konfiskimin e automjeteve të tyre.

Inspektorët e Tregut kanë inspektuar bizneset rreth pajisjes me dokumentacion të nevojshme, çmimet e produkteve dhe deklaracion si dhe tregëtarët lëvizës.

Inspektori Financiar ka evidentuar bizneset rreth kryerjes së obligimeve të takses komunale duke marr edhe masat e radhes-vërejtje për pagesë.

Inspektori i Ambientit ka kryer inspektime të deponive ilegale, në shqyrtim të kërkesave të palës dhe verifikimin e bizneseve rreth hyrjes së tyre në sistem të menagjimit të mbeturinave.

Në vazhdim po paraqesim një pasqyrë të punës në shifra:

Lëmia Inspektuese	Procesverbale	Aktivendime	Fletëparaqitje	Gjoha mandatore	Kërkesa për Pëlqim biz.	Pëlqim për biznes	Konfiskime të automjeteve
I.Sanitare	27				2	2	
I.Tregut	17	1					
I.Financiare	32						
I.komunikacionit	34		22				2
I.Ndërtimit	33	4	1	4			
I.Ambientit	22			2			
Gjithsej	165	5	23	6	2	2	2